

**SHENIMET SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE TË AKTIVITETIT TË MBYLLUR
TE VITIT 2020 PER SHOQUERINE TREGETARE "TURIZMI BEHAR KOCIBELLI"SH.P.K**

**A) DISA SQARIME NE LIDHJE ME SHENIMET SHPJEGUESE PER BILANCIN
E VITIT 2020**

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2. Shënimet shpjeguese në këtë bilanc japid përshtime me fjalë ose zërthime të zërave të paraqitura në këto pasqyra dhe informacione rrith zërave që nuk kualifikohen për njohje në këto pasqyra.

Shënimet shpjeguese japid: (a) informacione në lidhje me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikat specifike kontabël të përdorura; (b) informacion shpjegues të kërkuar nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit i cili nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare; dhe (c) informacion që nuk është paraqitur diku tjetër në pasqyrat financiare por është i nevojshëm për të kuptuar ndonjë prej tyre.

Kjo njësi ekonomike normalisht i paragjet shënimet shpjeguese në rendin e mëposhtëm:

- A). Një deklaratë që pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- B). Një përbledhje të politikave kontabël të rëndësishme të zbatuara;
- C). Informacion mbështetës për zérat e paraqitur në pasqyrat financiare, në rendin në të cilin paraqitet çdo pasqyrë dhe zë përkatës;
- D). Shënime të tjera shpjeguese.

Dhënia e informacioneve shpjeguese nga kjo njësi ekonomike për politikat kontabël.

Kjo njësi ekonomike më poshtë do të japë informacion shpjegues në vijim në përbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël:

- a). Baza e matjes (ose bazat) të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare;
- b). Politikat e tjera kontabël të përdorura, të rëndësishme për kuptimin e pasqyrave financiare.

Dhënya e Informacioneve në lidhje me burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit.

Njësia ekonomike "**TURIZMI BEHAR KOCIBELLI"SH.P.K**" kur e shikon të arsyeshme mund të japë informacione në shënimet shpjeguese rrith supozimeve kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, të cilat ka shumë mundësi të sjellin një rregullim material në vlerat kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Përsa i përket këtyre aktiveve dhe detyrimeve, shënimet shpjeguese përfshijnë detajet për:

- a). Natyrën e tyre;
- b). Vlerën e tyre kontabël në fund të periudhës raportuese.

Dhënya e Informacioneve në lidhje me "Palët e lidhura" dhe Shpjegime për këto pale.

Njësia ekonomike "**TURIZMI BEHAR KOCIBELLI"SH.P.K**" konsiderohet si e lidhur, me një pale tjetër nëse njëra pale ose kontrollon palën tjetër, ose ka një ndikim të ndjeshëm mbi palën tjetër. Ndikimi i ndjeshëm ekziston kur ajo lidhet me vendimet financiare dhe ato të shfrytëzimit. Palët janë të lidhura edhe kur ato janë nën kontrollin e përbashkët të një njësie tjetër. Ekzistenza e kontrollit, kontrollit të përbashkët ose ndikimit të ndjeshëm mund të ndikojnë mbi mënyrën se si të dyja palët hyjnë në aktivitete biznesi me njëra-tjetren. Prandaj, për t'i kuptuar sa më mirë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike, duhet të kuptohen mirë marrëdhëniet dhe kushtet, në të cilat palët e lidhura hyjnë në aktivitete biznesi me njëratjetren. Shembuj të palëve të lidhura përfshijnë: (a) njësia mëmë (dhe personat që kontrollojnë ose kanë ndikim të ndjeshëm mbi njësinë mëmë); (b) njësitë e kontrolluara; (c) pjesëmarjet; (d) sipërmarrje të tjera të të njëjtit grup konsolidimi (për shembull, njësitë e kontrolluara simotra); (e) drejtuesit, anëtarët e organit mbikëqyrës si dhe aksionarët që zotërojnë një pjesë të konsiderueshme të aksioneve, me përjashtim të atyre rasteve kur këta persona nuk e kanë mundësinë praktike të ushtrojnë influencë të ndjeshme mbi vendimet ekonomike të njësisë ekonomike raportuese; (f) të afërmit e ngushtë të personave të përmendur në pikën (e) (përfshirë këtu personat e afërt dhe fëmijët) si dhe njësitë ekonomike që janë nën kontrollin ose ndikimin e tyre. Njësia ekonomike "**TURIZMI BEHAR KOCIBELLI"SH.P.K**" nuk është e lidhur me ndonjë pale tjetër.

Përveç kërkësave të këtij standardi çdo standard tjetër i SKK-ve kërkon dhënie informacionesh shpjeguese përkatëse. Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese eshte bëre sipas kërkësave dhe strukturës

standarde te percaktuara ne SKK 2 dhe në SKK-të tjera 3-14 dhe konkretisht . radha e dhenies se shpjegimeve eshte si vijon:

- a) *Informacion i përgjithsëm dhe politikat kontabël.*
- b) *Shënimet qe shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare.*
- c) *Shënime të tjera shpjegeuse.*

B) INFORMACION I PËRGJITHSHËM PER PASQYRËN E PERFORMANCES TË HARTUAR NË MBYLLJE TË AKTIVITETIT EKONOMIK E FINANCIAR TË KRYER GJATË VITIT 2020

Kuadri ligjor:

Ligji LIGJ nr. 25-2018, date 10.5.2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Kuadri kontabel i aplikuar :

Standardet Kombetare te Kontabilitetit ne Shqiperi.(SKK 2; 49)

Baza e pergatitjes se PF :

Te drejtat dhe detyrimet e konstatuara.(SSK 1, 35)

Parimet dhe karakteristikat cilesore te perdonura per hartimin e P.F. : (SKK 1; 37 - 69)

a) NJESIA EKONOMIKE RAPORTUSE **"TURIZMI BEHAR KOCIBELLI"SH.P.K** mban ne llogarite e saj aktivet,pasivet dhe ka raprtuar te gjitha trasaktionet

b) VIJIMESIA e veprimtarise ekonomike te njesise sone raportuse eshte e realizuar duke siguruar vazhdimesi dhe duke mos pasur ne plan ose nevoje per nderprerjen e aktivitetit te saj.

c) KOMPENSIM midis nje aktivi dhe nje pasivi eshte bere ne rastin kur personi juridik ose fizik paraqitet si klient dhe si furnitor njekohesisht vetem ne rastet qe lejohen nga SKK.

d) KUPTUSHMERIA e Pasqyrave Financiare eshte realizuar ne masen e pote ne menyre qe informacioni i paraqitur te jete i standartizuar, i qarte dhe i kuptushem per perdonues qe kane njojuri te pergjithshme dhe te mjaftueshme ne fushen e kontabilitetit.

e) MATERIALITETI eshte vleresuar nga ana jone dhe ne baze te tij Pasqyrat Financiare jane te hartuara vetem per zera materiale.

f) BESUSHMERIA. Hartimi i Pasqyrave Financiare eshte e siguruar nepermjet punes se kujdeshme duke ruajtur vijimesine me kusht qe te gjithe zera e bilancit te jene material duke respektuar kerkesat e SKKve. Per ndertimin e pasqyrave financiare me te gjithe elementet e prezantuar ne to si kerkesa baze ka gene dhe mbetet zbatimi i SKKve.

Politikat kontabël

Pasqyrat Financiare te vitit 2020 jane ndertuar sipas SKK ve - referuar nenit 16 te ligjit r 25/2018 datë 10.05.2018."Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Ne ndertmin e pasqyrave financiare ndryshojne format e BK e te PASH sepse jane zbatuar kerkesat e SKK2. Shifrat e vitit 2020 jane bere te krahasushme me ato te viteve parandhes 2009- 2018. Per realizimin e kesaj detyre jane bere te gjitha rregullimet e mundshme me qellim qe informacioni kontabel te krahasohet ne dinamikë.

Lista e llogarive e perdonur per vitin 2020 eshte ajo e publikuar nga "Keshilli Kombetar i Kontabilitetit" dhe eshte e pershtatur per zbatimin sa me te pote te SKKve gjate vitit 2020.

Per mbajtjen e inventareve jane percaktuar metodat e inventarizimit dhe menyra e vleresimit te tyre. me qellim qe te jene te plotesuara kerkesat e SKK 4. 15 dhe konkretisht:

a) Per lendet e para, per produktet e gatshme dhe per mallrat eshte perdonur menyra e inventarizimit te vazhdueshem ndersa vleresimi i tyre eshte bere me metoden "Vleresim me kosto mesatare te ponderuar".

b) Per artikujt ushqimore eshte perdonur inventarizimi i ndermjetem bazuar ne metoden e "Vleresimit me kosto mesatare te ponderuar "SKK 4,15".

Vleresimi fillestar i nje elementi te AAM qe ploteson kriteret per njojje si aktiv ne bilanc eshte bere me koston e pote (SKK 5; 11). Per prodhimin ose krijimin e AAM kur kjo financohet nga nje hua, kostot e huamarrjes deri ne perfshirjen e aktivit plotesisht ne bilanc (plus interesat) kapitalizohen ne koston e aktivit vetem per periudhen e investimit deri ne perfundimin e tij (SSK5:16).

Me pas kur AAM-ja eshte marre ne kontabilitet si i tillle, interesat dhe kostot e tjera te huamarrjeve i jane ngarkuar rezultatit te vitit ushtrimor te aktivitetit duke u bazuar ne te dhenat konkrete te amortizimit te kredive te marra nga njesia ekonomike.

Per vleresimin e mepasshem te një AAM-je eshte zgjedhur modeli i kostos fillestare te fiksuar duke e paraqitur ne bilanc me kosto minus amortizimin e akumuluar(SKK 5; 21).

Per llogaritjen e amortizimit te AAM-ve (SKK 5: 38) jane perdorur metodat e pranuara nga Ligji per "Tatimin mbi te ardhurat" ku si metode e amortizimit te ndertesave perdorim metoden lineare mbi vlerën e mbetur por dhe per AAM-te e tjera perdorim metoden lineare te llogaritjes se shpenzimeve të amortizimit mbi bazen e vlefte se mbetur te AAM-ve. Normat e amortizimit jane te njejtë me ato te pranuara nga sistemi fiskal ne fuqi dhe konkretisht :

- Per ndertesat ne menyre lineare mbi vleren e mbetur deri me 5 % ne vit.
- për kompjutera e sisteme informacioni deri me 25 % te vlefte se mbetur
- Për të gjitha AAM-të e tjera deri me 20 % te vlefte se mbetur.

Mbajtja e kontabilitetit eshte realizuar ne menyre kompjuterike me programin ALPHA.

C). SHPJEGIME DHE KOMENTE PER TREGUESIT E VENDOSUR NE PASQYREN E POZICIONIT FINANCIAR TE MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020

Aktivet monetare ne masen 3,230,950 lek perbejne mjetet monetare te cilat ndodhen ne llogarite bankare dhe ne arke. Ne kete shoqeri ka veçori se ne arke ka ne cdo kohe mjete sepse natyra e aktivitetit eshte qe shitjet kryhen me kase fiskale.

Gjendja ne banke nuk nuk eshte negative sepse ne banke ekzistojne 1,902,762.00 lek. Efektet te overdrafteve ne EURO ose ne USD nuk kane dhene rezultate negative por e kane çuar bankën në paksim . Rezultatet konkrete jepen ne pasqyren shoqueruese per keto shenime bashkangjitur ketij materiali. Aty jane dhene konkretisht llojet e monedhave dhe llojet e llogarive ne monedha te ndryshme per bankat dhe per arken.

Llogarite e kerkesave te arketueshme perbejne nje burim te rendesishem te sigurt per vazhdimin normal te biznesit . Kerkesat e arketueshme jane ne masen 4,567,980 lek dhe keto perbehen nga kerkesat ndaj klienteve në vlerën 4,173,110 dhe nga kerkesa te tjera te arketushme janë në masen 394,870 lek.

Në kërkesat e tjera të arkëtueshme përfshihet Tatim fitimi të mbipaguar në vlerën 0 lek dhe TVSH-ja kreditore e mbipaguar në vlerën 4,173,110 lekë. TVSH-ja kreditore është në debi në masen 4,173,110.00 lek për shkak se janë kryer shumë punime të brëndëshme në ndërtesen Nr 2 "Përballë katedrales" të cilat në vlerën më të madhe janë (furnizim vendosje). Vlera e këtyre punimeve të cilat realisht janë riparime nuk janë kontabilizuar në vlerën e AAM-ve pasi janë zbatuar Kërkesat e SKK Nr 5 paragrafi 43 ku thuhet: (*Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor*). Keto kerkesa ndjekin rrjedhen e likujdimeve te zakonshme në kohë.

Detyrimet në total janë 434,404,628 leke nga të cilat detyrimet ndaj furnitorëve janë 9,758,446 lek dhe detyrimet tativore janë 381,641.00 lek. Këto detyrime tativore janë sigurime shoqërore në masen 98,142.00 lekë, detyrime për TAP 3,640 00 lekë dhe detyrime për tatim fitimi 279,859 00 lekë Për TVSH-në nuk ka detyrime dhe është në masen 0 lekë. Detyrimet e tjera perbejne kontributin e pronarit ne bisnes ne masen 288,398,083.80 lekë. Keto kontribute jane te materializuara per investime ne objektin e ndertuar te hotelit dhe ne paisje, mobilje dhe orendi per hotelin. Pjesa tjeter e kredive afatgjata ndaj bankave është ne masen 135,866,458.15 lekë. Kjo hua afatgjatë është marrë për blerjen e një ndërtese e cila pasqyrohet na pasqyrën analitike të AAM-ve. Detyrimet ndaj punonjesve janë 0 lek.

Ne lidhje me inventaret dhe mallrat per rishitje jane paraqitur gjendjet dhe levizjet e magazinave te lendeve te para dhe te mallrave te cilat i bashkangjiten materialit. Mallrat e tjera jane vleresuar me cmimin e fatures se blerjes ne import.

Per aktivet afatgjata material Jane zbatuar kerkesat e (SKK 5:90,91,92,93)te cilat Jane te shprehura ne pasqyrat qe i bashkangjiten materialit. Konkretisht Jane dy tabela. Njera shpreh llojshmerine dhe vleren fillestare per secilin aktiv ne momentin e marrjes ne kontabilitet kurse tjetra shpreh amortizimin e akumuluar dhe amortizimin e llogaritur te AAMve sipas grupeve. Per kete shoqeri nuk eshte llogaritur amortizim.

Gjithashtu ketu jepen edhe hyrje daljet e aktiveve ne grupe gjate vitit te cilat perbejne ato qe quhen ndryshime ne inventarin e Aktiveve afatgjata materiale.

Detyrimet tativore perbejnë sigurime shoqërore në masen 98,142.00 lekë, detyrime për TAP- in në masen 3,640.00 lekë dhe detyrime për tatim fitimi 279,859.00 lekë. Për TVSH-në nuk ka detyrime dhe është në masen 0 lekë

Në periudhën Janar-Mars 2020 ato jane likujduar.Nje natyre te tille ka edhe detyrimi i vendosur ne bilanc per pagat e punonjesve dhe per tatim-fitimin qe duhet paguar ne masen 0 lek dhe për TVSH-në që paguhet brënda datës 14 Janar 2020 por në rastin tonë ky detyrim është në vlerën 0 lekë.

Gjithe kapitali i shoqerise "TURIZMI BEHAR KOÇIBELLI SH.P.K" eshte i percaktuar sakte neper llogarite perkatese. Shprehemi se pjeset e kapitalit qe perbejne rezervat dhe fitimin e mbartur ketu e kane burimin ne fitimet e mbartura nga vitet e meparshme. Ne kete shoqeri tregetare ka rezerva te krijuara nga fitimet e mbarturtura. Kjo shoqeri ka bërë zmadhim kapitali i cili është deklaruar në bilanc dhe konkretisht është në vlerën 26.000.000 lekë. Në kapitalet e veta ndodhen kapitali i derdhur në vlerën 26,000,000 lekë, fitimi i viti ushtrimor dhe ai i mbartur qe ka si burim aktivitetin ne vite .Te gjitha fitimet neto te realizuara ne vite ekzistojne ne masen 9,221,369 lek kurse fitimi neto i viti ushtrimor 2020 është në masën 2,160,556 lekë. Kjo shoqeri tregtarë nuk ka shperndare asnje vit dividend.

Per te analizuar te dhena me te hollesishme per secilin ze te bilancit dhe per te gjetur ndikimin e faktoreve ne nivelin e tregueseve baze duhet ti referohemi gjendjes se llogarive ne materialet bashkangjitur dhe me tej karteles per secilen llogari.

D) SHPJEGIME DHE KOMENTE PER TREGUESIT E VENDOSUR NE "PASQYREN E E PERFORMANCES PËR TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET TË KRYERA PER VITIN 2020.

PASHja eshte paraqitur per te ardhura dhe shpenzime sipas natyres ne te gjithe elementet perberes te saj. Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit (këtu nuk përfshihen rritjet, që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital). Burimi kryesor i të ardhurave të një njësie ekonomike është shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve. Burime të tjera, si interesi, dividendët, dhe grandet qeveritare përbëjnë një element tjetër të të ardhurave.

Të ardhurat sipas burimeve të aktivitetit të tyre paraqiten si më poshtë:

1	70401	Te ardhura nga fjetja ne hotel	LEK		36,822,136.23
2	70403	Te ardhura nga ambientet me qera	LEK		1,608,032.50
3	70404	Te ardhura nga sherbimet e barit	LEK		1,618,933.33
4	70405	Te Ardhura nga Restoranti	LEK		2,140,858.33
5	708	Të ardhura nga shtije te tjera	LEK		26,758.33
6	767	Të ardhura nga interesat	LEK		49,298.61
7	76901	Fitime nga azhornimi i Arkes/Bankes	LEK		66,996.56
		SHUMA			42,333,013.89

Ne kete shoqeri ka rritje në te ardhura me 10% ndersa norma e fitimit fitimi eshte ulur vetëm 5% për shkak të ndikimit të pandemisë. Të gjitha materialet e ndërtimit ne bazë të standartit SKK Nr 5 janë ngarkuar si shpenzime të periudhës ndërsa norma e amortizimit të ndërtëses është mbajtur 2% duke kompuesuar shpenzimet përi riparime te cilat kanë përmirësuar cilësin e ndërtëses. Ne bilanc shpenzimet jane paraqitur sipas natyres se tyre per materiale, paga,tatime dhe taksa, amortzime dhe shpenzime te tjera. Ne zerin shpenzime te tjera kryesisht jane perfshire ato te natyres se shpenzimeve te panjohura nga fisku.Zerin kryesor e zene Materialet e para dhe pagat.Pagat zene -4,382,718 lek kurse materialet kapin vleren - 31,273,721 lek.

Te gjitha llogarite e te ardhurave jane mbajtur me kartela analitike te veçanta dhe ne to del qarte burimi se si jane siguruar keto te ardhura.Kjo shoqeri ka si baze sherbimet turistike me bar restorant, hotel dhe sala konferencash dhe tregtimin e mallrave te ndryshem.

Pasqyra e flukseve te parase eshte ndertuar sipas metodes indirekte ndersa pasqyra e levizjes se kapitalit eshte ndertuar ne baze te te dhenave te regjistruara ne kontabilitet sipas kerkesave te SKK 2.

E). DISA SHPJREGIME NE LIDHJE ME TATIMET E SHTYRA.

Ne kete bilanc jane vendosur disa tatime te shtyra ne pozicionin debitor e kreditor per te cilat ja vlen te sqarojme sa me poshte:

Detyrimet tatumore perbejnë sigurime shoqërore në masën 98,142.00 lekë, detyrime për TAP- in në masën 3,640.00 lekë dhe detyrime për tatum fitimi 279,859.00 lekë. Për TVSH-në nuk ka detyrime dhe është në masën 0 lekë

Detyrimet e tjera perbejne kontributin e pronarit ne bisnes dhe Kredi bankare për të cilat kemi dhënë shpjegime më sipër. Keto kontribute jane te materializuara per investime ne objektin e ndertuar te hotelit dhe ne paisje, mobilje dhe orendi per hotelin. Pjesa tjeter e kredive afatgjata ndaj bankave që në momentin filletar ka qënë ne masen 124,000,000.00 lekë cila është përdorur për blerjen e një ndërtese përballë Katedrales në Korçë. Detyrimet ndaj punonjesve janë 0 lek.

Per kete shoqeri tregetare jane modeluar 3 magazina sipas natyres se materialeve. Për vitin 2020 nuk është bërë asnjë veprim për telavizionin Lobi. Kjo shoqeri duhet te paguaje Tatim Fitimi shtese per vitin 2020 në vlerën 279,859 lekë sepse nuk ka paguar tatum fitimi gjatë vitit 2020. Detyrimet e tjera tatumore per sigurimet shoqërore jane ne rrjedhen normale te tyre nprmale për të cilat kemi dhënë shpjegimë më sipër..

F) INFORMACION RRETH GJYKIMEVE DHE RRETH BURIMEVE KYÇE TË PASIGURISË SË VLERËSIMIT

Nga të dhënat e paraqitura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2020 dhe në bazë të komfirmimeve nga "Asambleja e ortakëve" të Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "TURIZMI BEHAR KOÇIBELLI" SH.P.K, ne kemi siguruar evidencë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se parimi i vijimësë së aktivitetit Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "TURIZMI BEHAR KOÇIBELLI" SH.P.K është cënuar në zvogëlimin e xhiros por nuk cënoshet nga ndikimi i "Virusit Covid 19". Pra kjo "Shoqëri tregtare do të vazhdojë të funksionojë normalisht në të gjitha aktivitetet tregtare që kryen pavarësisht nga rezultatet që do të arrihen.

Vlerësimi i inventareve si për AAM-të dhe për lëndët e para dhe për materjalet gjëndje më 31.12.2020 është i saktë. Pasiguri ka në vlerësimin e AAM-ve e të mjeteve të inventarit të imët dhe në pagesat e taksave dhe të tarifave vjetore të tyre. Deklarimi i të ardhurave dhe i shpenzimeve ka një nivel të caktuar pasigurie e cila është relativisht e pa përfillshme. Veprimet e arkëtimeve janë nga shërbimet ndaj klientëve me kasë por edhe mallrat për shërbime janë paguar sipas faturave që kanë bashkangjitur kuponin e kasës. Burimet e financimit të investimeve mbulohen tërësisht me fitimet neto të realizuara gjatë viteve ushtrimore dhe me kredi afatgjatë. Por kjo analizë për ne përbën pasiguri për shkak se nuk janë deklaruar tërësisht huamarjet private.

Pjeset perberse te bilancit te shoqerise "TURIZMI BEHAR KOÇIBELLI" SH.P.K jane

Bilanci Aktiv pasiv per vitin 2020

Dy flete.

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve

Nje flete

Pasqyra e flukseve te parase sipas metodes indirekte

Nje flete.

Pasqyra e levizjes se kapitalit per vitin 2020

Nje flete

Listat e inventareve te mallrave dhe te materialeve me 31.12.2020

Kater flete

Lista e inventarit AAMve me 31.12.2020

Nje flete

Lista e gjendjes se llogarive me 31.12.2020

Dy flete

Tabela e llogaritjes se amortizimit per vitin 2020

Nje flete

Deklarata vjetore e Tatimit mbi fitimin te vitit 2020

Nje flete

Deklarata Analitike e tatimit mbi te ardhurat per vitin 2020

Nje flete

Inventari i llogarive bankare per vitin 2020

Nje flete

Pasqyra e inventarit te automjeteve per vitin 2020

Nje flete

Paqyra e analizes se TVSH-se per vitin 2020

Nje flete

Pasqyra permbladhese e Sigurimeve per vitin 2020

Nje flete

Shenime shpjeguese për bilancin e vitit 2020

Pesë flete

Pasqyra statistikore

Tre flete

Kontrata e sipermarrijes

Dy flete

Shenim Bilanci eshte hartuar ne tre kopje . Te gjitha jane te hartuara, te vulosura e firmosura ne te njejten forme.

Hartuesi

Administratori

Rruzhdi SHKULLAKU

Aurel KOÇIBELLI

